

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehures M.K., nga P., për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 418 par. 1 të KPRK-së, e akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4700/2017, të dt:15.02.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP.II.nr.4700/2017, të dt:15.02.2018, më **14.05.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4700/2017, të dt:15.02.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

E pandehura:

M.K., nga i ati B., e ëma F., e gjinisë I., i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin M., Komuna e P., e gjendjes së memse ekonomike, me numër personal ..., me numër të tel. ..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 01.08.2017, rreth orës 08:05h, në pompën e derivateve "A. – P.", në Q., në P., e pandehura në mënyrë arbitrare ka ushtruar të drejtën të cilën ka menduar se i takon, pa i'u drejtuar organit kompetent, ashtu që e mllëfosur se pronari i kompanisë "A. – P.", ku e pandehura kishte punuar, i kishte mbetur borxh shumë e parave në vlerë prej 280 euro, e njëjta ditën kritike e kishte mbushur veturën e saj me derivate të naftës në vlerë prej 50 euro, të cilat nuk i kishte paguar me arsyetimin se ata i kishin mbetur borxh dhe ishte larguar nga aty, me qëllim të realizimit të borxhit;-

Me këtë ka kryer veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehures M.K. i shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

E pandehura: **M.K.** dënohet me gjobë në shumë prej **200.00 € (dy qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohet e pandehura që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: A.B., me vendbanim në Rr."D. e M.", në P., për realizimin e kërkesës pasuror juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP.II.nr.4700/2017, të dt:15.02.2018, ka akuzuar M.K., se ka kryer veprën penale – Vetëgjygjësia nga neni 418 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-AD-2192 të datës 03.07.2017, deklarata e të pandehures e dhënë në procedurën paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se e pandehura M.K., është penalisht përgjegjëse për kryerjen e veprës penale Vetëgjygjësia nga neni 418 par. 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtes i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehures, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.937/2018 të dt. 14.05.2018

**Procesmbajtësja,
Sanije Troshupa**

**G j y q t a r i
Rrustem Begolli**

KËSHILLA JURIDIKE:

Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.